



INSTITUTI PËR
SHKENCË DHE ARTE
UNIVERSITETI HAXHI ZEKA

HARTËZIMI I BIZNESEVE NË RRAFSHIN E DUKAGJINIT

*INSTITUTI PËR SHKENCË DHE ARTE
Universiteti “Haxhi Zeka”, Pejë*

UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA”



INSTITUTI PËR SHKENCË DHE ARTE



**INSTITUTI PËR
SHKENCË DHE ARTE**
UNIVERSITETI HAXHI ZEKA

HARTËZIMI I BIZNESEVE NË RRAFSHIN E DUKAGJINIT

Raport i hartuar nga Instituti për Shkencë dhe Arte

Pejë, Gusht 2024

**© Të gjitha të drejtat për përdorimin e raportit janë të rezervuara ekskluzivisht për
Institutin për Shkencë dhe Arte, Universiteti “Haxhi Zeka”**

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE	5
LISTA E FIGURAVE.....	5
LISTA E GRAFIKËVE	5
LISTA E SHKURTESAVE	7
HYRJE	8
METODOLOGJIA	12
FAZAT E HULUMTIMIT	14
DIZAJNI I DATABAZËS	15
PËRGATITJA DHE VIZUALIZIMI I TË DHËNAVE.....	16
LLOJET E BIZNESEVE NË RRAFSHIN E DUKAGJINIT.....	17
Biznes Individual (B.I.).....	18
Ortakëri e Përgjithshme (O.P.).....	18
Ortakëri e Kufizuar (O.K.)	18
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara (SH.P.K.)	18
Ndërmarrje Shoqërore (N.SH.)	19
Shoqëri Aksionare (SH.A.)	19
Ndërmarrje Publike (N.P.)	19
Kooperativa Bujqësore (K.B.).....	19
Dega e Shoqërisë së Huaj	19
Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM.....	19
VEPRIMTARITË EKONOMIKE NË RRAFSHIN E DUKAGJINIT	43
STATISTIKAT E BIZNESEVE SIPAS VEPRIMTARIVE EKONOMIKE	45
KONKLuzionET REKOMANDIMET KUFIZIMET.....	81
KONKLuzionE TË PËRGJITHSHME.....	82
REKOMANDIMET.....	83
KUFIZIMET E STUDIMIT.....	84
BIBLIOGRAFIA DHE REFERENCAT	86
SHTOJCË.....	87

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Statistikat e bizneseve sipas llojit në 10 Komunat e përfshira në analizë	20
Tabela 2. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Pejës	33
Tabela 3. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Deçanit.....	34
Tabela 4. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Klinës	35
Tabela 5. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Istogut	36
Tabela 6. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Junikut	37
Tabela 7. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Gjakovës	38
Tabela 8. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Rahovecit.....	39
Tabela 9. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Suharekës	40
Tabela 10. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Prizrenit	41
Tabela 11. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Malishevës	42
Tabela 12. Struktura e gjerë e NACE Rev. 2.....	87

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Fazat e hulumtimit	14
Figura 2. Dizajni i databazës.....	15

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Statistikat e bizneseve sipas llojit në 10 Komunat e përfshira në analizë	22
Grafiku 2. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Biznes Individual” në 10 Komunat e përfshira në analizë	23
Grafiku 3. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Ortakëri e Përgjithshme” në 10 Komunat e përfshira në analizë	24
Grafiku 4. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara” në 10 Komunat e përfshira në analizë	25
Grafiku 5. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Dega e Shoqërisë së Huaj” në 10 Komunat e përfshira në analizë ...	26
Grafiku 6. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Ndërmarrje Publike” në 10 Komunat e përfshira në analizë	27
Grafiku 7. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Ndërmarrje Shoqërore” në 10 Komunat e përfshira në analizë	28
Grafiku 8. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Shoqëri Aksionare” në 10 Komunat e përfshira në analizë	29
Grafiku 9. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM” në 10 Komunat e përfshira në analizë	30
Grafiku 10. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Ortakëri e Kufizuar” në 10 Komunat e përfshira në analizë	31
Grafiku 11. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Kooperativa Bujqësore” në 10 Komunat e përfshira në analizë	32
Grafiku 12. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Pejës	33
Grafiku 13. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Deçanit.....	34
Grafiku 14. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Klinës	35
Grafiku 15. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Istogut.....	36
Grafiku 16. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Junikut	37
Grafiku 17. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Gjakovës	38
Grafiku 18. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Rahovecit.....	39
Grafiku 19. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Suharekës	40

Grafiku 20. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Prizrenit	41
Grafiku 21. Statistikat e bizneseve sipas llojit në Komunën e Malishevës	42
Grafiku 22. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në 10 Komunit e përfshira në analizë	45
Grafiku 23. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “A - Bujqësi, pylltari dhe peshkatari” në 10 Komunit e përfshira në analizë	47
Grafiku 24. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “B - Xehetari dhe guroret” në 10 Komunit e përfshira në analizë	48
Grafiku 25. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “C - Prodhim” në 10 Komunit e përfshira në analizë	49
Grafiku 26. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “D - Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe furnizimi me ajr të kondicionuar” në 10 Komunit e përfshira në analizë	50
Grafiku 27. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “E - Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës” në 10 Komunit e përfshira në analizë	51
Grafiku 28. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “F - Ndërtimtari” në 10 Komunit e përfshira në analizë	52
Grafiku 29. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “G - Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave” në 10 Komunit e përfshira në analizë	53
Grafiku 30. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “H - Transport dhe ruajtje” në 10 Komunit e përfshira në analizë	54
Grafiku 31. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “I - Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim” në 10 Komunit e përfshira në analizë	55
Grafiku 32. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “J - Informacion dhe komunikim” në 10 Komunit e përfshira në analizë	56
Grafiku 33. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “K - Aktivitete financiare dhe të sigurimit” në 10 Komunit e përfshira në analizë	57
Grafiku 34. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “L - Aktivitete të patundshmërisë” në 10 Komunit e përfshira në analizë	58
Grafiku 35. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “M - Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike” në 10 Komunit e përfshira në analizë	59
Grafiku 36. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “N - Aktivitete administrative dhe mbështetëse” në 10 komunit e përfshira në analizë	60
Grafiku 37. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “O - Administratë publike dhe mbrojtje; sigurim social i detyrueshëm” në 10 Komunit e përfshira në analizë	61
Grafiku 38. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “P - Arsim” në 10 Komunit e përfshira në analizë	62
Grafiku 39. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “Q - Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale” në 10 Komunit e përfshira në analizë	63
Grafiku 40. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “R - Art, zbavitje dhe rekreacion” në 10 Komunit e përfshira në analizë	64
Grafiku 41. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarisë ekonomike “S - Aktivitete të shërbimeve tjera” në 10 Komunit e përfshira në analizë	65
Grafiku 42. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në Komunën e Pejës	66
Grafiku 43. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në Komunën e Deçanit	67
Grafiku 44. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në Komunën e Klinës	69
Grafiku 45. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në Komunën e Istogut	70
Grafiku 46. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në Komunën e Junikut	71
Grafiku 47. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në Komunën e Gjakovës	73
Grafiku 48. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në Komunën e Rahovecit	74
Grafiku 49. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në Komunën e Suharekës	76
Grafiku 50. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në Komunën e Prizrenit	77
Grafiku 51. Statistikat e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike në Komunën e Malishevës	79

LISTA E SHKURTESAVE

<i>AKM</i>	<i>Agjencia Kosovare e Mirëbesimit</i>
<i>AKP</i>	<i>Agjencia Kosovare e Privatizimit</i>
<i>ARBK</i>	<i>Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës</i>
<i>B.I.</i>	<i>Biznes Individual</i>
<i>D.K.</i>	<i>Dega në Kosovë</i>
<i>ISHA</i>	<i>Instituti për Shkencë dhe Arte</i>
<i>K.B.</i>	<i>Kooperativa Bujqësore</i>
<i>N.P.</i>	<i>Ndërmarrje Publike</i>
<i>N.SH.</i>	<i>Ndërmarrje Shoqërore</i>
<i>NVM</i>	<i>Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme</i>
<i>O.K.</i>	<i>Ortakëri e Kufizuar</i>
<i>O.P.</i>	<i>Ortakëri e Përgjithshme</i>
<i>ODK</i>	<i>Open Data Kosovo</i>
<i>SH.A.</i>	<i>Shoqëri Aksionare</i>
<i>SH.P.K.</i>	<i>Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar</i>
<i>UHZ</i>	<i>Universiteti “Haxhi Zeka”</i>

HYRJE

Procesi i hartëzimit të bizneseve është një instrument thelbësor për zhvillimin harmonik e të qartë të Institucioneve të Arsimit të Lartë, Ministrive kompetente, Qeverive lokale, OJQ-ve, pedagogëve, studentëve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në zhvillimin ekonomik dhe social. Ky proces lejon identifikimin dhe klasifikimin e të gjitha bizneseve që veprojnë në një rajon të caktuar, duke krijuar një bazë të dhënash të detajuar që mund të përdoret për studim, planifikim, vendimmarrje dhe zhvillim strategjik.

Për Institucionet e Arsimit të Lartë, duke e përfshirë në mënyrë të veçantë këtu Universitetin “Haxhi Zeka”, procesi i hartëzimit të bizneseve është njëra ndër veprimtaritë e rëndësishëm sepse ofron një pasqyrë të qartë të nevojave dhe tendencave të tregut. Kjo ndihmon në përmirësimin e kurrikulave, duke i bërë ato më të përshtatshme për kërkesat e tregut të punës dhe duke i përgatitur studentët me aftësi dhe njohuri që janë të nevojshme për sukses në karrierat e tyre të ardhshme. Hartëzimi mund të ndihmojë në identifikimin e mundësive për bashkëpunime kërkimore dhe projekte të përbashkëta me industrinë.

Ministritë kompetente dhe Qeveritë lokale përfitojnë nga ky proces duke marrë një pamje të plotë të ekonomisë lokale dhe rajonale. Kjo i lejon ata të planifikojnë dhe zbatojnë politika efektive ekonomike dhe zhvillimore. Duke pasur të dhëna të sakta dhe të përditësuara mbi bizneset, ministritë dhe qeveritë lokale mund të

krijojnë programe mbështetëse që janë më të përshtatshme për të ndihmuar rritjen dhe zhvillimin e sektorëve specifikë të ekonomisë. Gjithashtu, u mundëson atyre të monitorojnë zhvillimin ekonomik dhe të marrin masa të përshtatshme për të mbështetur bizneset lokale.

OJQ-të, të cilat shpesh fokusohen në zhvillimin ekonomik, mund të përdorin hartëzimin e bizneseve për të identifikuar nevojat dhe sfidat kryesore të komuniteteve lokale. Kjo u mundëson atyre të krijojnë dhe të zbatojnë programe që mbështesin bizneset e vogla dhe të mesme, të inkurajojnë inovacionin dhe të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm. Hartëzimi i ndihmon OJQ-të të zhvillojnë strategji efektive për ndërhyrje, të cilat janë të bazuara në të dhëna reale dhe të verifikuara.

Pedagogët dhe studentët përfitojnë drejtpërdrejt nga ky proces, pasi ai ofron mundësi të shumta për hulumtime të bazuara në të dhëna konkrete. Pedagogët mund të përdorin hartëzimin për të zhvilluar projekte kërkimore që lidhen me nevojat aktuale të biznesit dhe ekonomisë, duke i dhënë kështu mësimdhënies një qasje më praktike dhe të orientuar nga tregu. Studentët mund të angazhohen në projekte praktike që lidhen me bizneset lokale, duke fituar përvojë reale dhe duke krijuar lidhje të rëndësishme me industrinë që do të jenë të vlefshme për karrierën e tyre të ardhshme.

Është e vërtetë dhe e pa kontestueshme se, procesi i hartëzimit të bizneseve është një mjet i fuqishëm që kontribuon në zhvillimin ekonomik dhe social të një rajoni. Ky proces ndihmon aktorë të ndryshëm - nga qeveritë

dhe institucionet akademike e deri te OJQ-të dhe studentët të ndërmarrin veprime të informuara dhe të mbështetura nga të dhëna të sakta, duke siguruar që strategjitë dhe politikat e tyre të jenë më efektive dhe të përshtatshme për nevojat e komunitetit.

Me konkretisht, operacioni gjegjësisht veprimtaria e hartëzimit të bizneseve në një rajon të caktuar, siç është rajoni i Dukagjinit, i realizuar nga Instituti për Shklencë dhe Arte i Universitetit “Haxhi Zeka” pa dyshim sjell një sërë rezultatesh të rëndësishme që do të kontribuojnë në zhvillimin shkencor, akademik, ekonomik dhe social të kësaj zone. Ky proces përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për bizneset ekzistuese, si dhe identifikimin e mundësive të reja për investime dhe zhvillim.

Dimensionimi ekonomik:

Identifikimi i strukturës ekonomike: Me këtë proces konsiderojmë se do të ndihmohet në krijimin e një pasqyre të qartë të strukturës ekonomike të rajonit. Kjo përfshin kategorizimin e bizneseve sipas sektorëve, si prodhimi, shërbimet, bujqësia, industria, etj. Njohja e kësaj strukture është kyçe për të kuptuar se cilët sektorë janë më të zhvilluar dhe cilët kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme.

Vlerësimi i potencialit për zhvillim: Me këtë studim mundësohte identifikimi i potencialit për zhvillim ekonomik në rajon. Duke analizuar të dhënat e mbledhura, mund të identifikohen zonat ku ka mungesë të bizneseve të caktuara dhe ku ka hapësirë për investime të reja. Kjo krijon mundësi për të

tërhequr investitorë të rinj dhe për të krijuar vende të reja pune.

Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve: Rezultatet e hartëzimit mund dhe do të përdoren për të përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet në rajon. Nëse identifikohen zona me përqendrim të lartë biznesesh, por me infrastrukturë të dobët, autoritetet mund të investojnë në përmirësimin e rrugëve, energjisë, ujit dhe shërbimeve të tjera thelbësore, gjë që ndihmon në rritjen e konkurrencës dhe produktivitetit të bizneseve.

Mbështetja për bizneset ekzistuese: Duke pasur një pasqyrë të plotë të bizneseve ekzistuese, autoritetet mund të zhvillojnë politika mbështetëse më të mira. Kjo përfshin ndihmë në trajnim, financim dhe lehtësime të tjera që ndihmojnë bizneset të rriten dhe të qëndrojnë konkurruese.

Planifikimi dhe politikëbërja: Të dhënat e grumbulluara nga procesi i hartëzimit janë thelbësore për hartimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit. Ato u japin autoriteteve një bazë të fortë për të marrë vendime të informuara që synojnë përmirësimin e klimës së biznesit dhe rritjen ekonomike të rajonit të Dukagjinit.

Andaj, mund të theksohet se procesi i hartëzimit të bizneseve në një rajon të caktuar si Dukagjini krijon një platformë të fuqishme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, duke u bazuar në një analizë të detajuar dhe të mirëfilltë të potencialeve dhe sfidave të rajonit.

Dimensioni akademik

Procesi i hartëzimit të bizneseve është një mjet shumë i rëndësishëm në sferën e zhvillimit akademik të një universiteti e në këtë rast edhe për universitetin “Haxhi Zeka”. Ky proces i lejon universitetit të krijojë lidhje më të ngushtë me komunitetin ekonomik të rajonit, duke përfutur nga informacionet e detajuara për bizneset lokale. Kjo lidhje ndihmon universitetin të përshtasë programet e tij akademike dhe kërkimore me nevojat reale të tregut të punës dhe ekonomisë lokale, duke e bërë më të lehtë për studentët e institucionit tanë të kalojnë nga bota akademike në atë profesionale.

Për shembull, nëse një universitet identifikon se në rajon ka një numër të madh të bizneseve në sektorin e teknologjisë së informacionit, ai mund të zhvillojë programe të reja studimore, kurse trajnimi dhe laboratorë kërkimorë që përputhen me nevojat e këtij sektori. Në këtë mënyrë, studentët e atij universiteti do të jenë më të përgatitur për tregun e punës, ndërsa universiteti kontribuon në zhvillimin ekonomik të rajonit.

Gjithashtu, krijimi i hartës së bizneseve do t'i mundësojë universitetit të krijojë partneritete strategjike me biznese të ndryshme për projekte kërkimore dhe inovative. Këto partneritete jo vetëm që do të forcojnë kapacitetet kërkimore të universitetit, por edhe rrisin mundësitë për financim dhe përfshirje të studentëve në projekte reale, duke e bërë procesin e mësimdhënies më të ndërlydhur me praktikën më të mira të industrisë.

Përveç kësaj, këto të dhëna mund të përdoren për të identifikuar mundësitë për inkubim të bizneseve të reja dhe inovative brenda universitetit. Kjo është e rëndësishme për krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm të inovacionit dhe sipërmarrjes, ku idetë e reja të studentëve dhe stafit akademik mund të zhvillohen dhe të komercializohen me ndihmën e bizneseve ekzistuese.

Në mënyrë të sigurtë, hartëzimi i bizneseve ndihmon universitetin të kontribuojë në zhvillimin e politikave lokale dhe kombëtare për përmirësimin e edukimit dhe zhvillimit ekonomik. Duke pasur një kuptim të qartë të strukturës ekonomike dhe nevojave të tregut të punës në rajon, universiteti do të mund të propozojë politika dhe iniciativa që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë të komunitetit, duke ndikuar pozitivisht në të ardhmen e studentëve të tij dhe të ekonomisë së përgjithshme.

Dimensioni shkencor

Procesi i hartëzimit të bizneseve dhe mbledhja e të dhënave të tyre janë thelbësore për zhvillimin e shkencës në universitetin “Haxhi Zeka” por edhe për Institucionet tjera të Arsimit të Lartë e të Mesëm. Pa dyshim, për herë të parë që nga ekzistenca e vet, ky proces i ka mundësuar universitetit të krijojë një bazë të dhënash të detajuar dhe të saktë për bizneset lokale, sektoret e tyre të veprimtarisë, dhe kapacitetet teknologjike dhe inovative që ato posedojnë. Këto të dhëna janë të rëndësishme për kërkimet shkencore, pasi i ofrojnë akademikëve dhe studentëve një pamje të qartë të fushave ku ka nevojë për inovacion dhe kërkim shkencor, duke ndihmuar në përcaktimin e

e prioriteteve dhe drejtimit të kërkimeve.

Përveç kësaj, të dhënat e mbledhura nga hartëzimi i bizneseve jo vetëm që do të mundësojnë por edhe do të garantojnë krijimin e bashkëpunimeve të frytshme midis universitetit dhe sektorit privat. Universiteti do t'i përdorë këto të dhëna për të identifikuar partnerë potencialë për projekte kërkimore të përbashkëta dhe aplikative, duke sjellë në këtë mënyrë burime shtesë financimi dhe mundësi për kërkime të avancuara. Bashkëpunimet e tilla jo vetëm që forcojnë kapacitetet kërkimore të universitetit, por gjithashtu rrisin ndikimin e tij në komunitetin lokal dhe më gjerë.

Në sferën e zhvillimit të shkencës, të dhënat nga bizneset lokale do të ndihmojnë universitetin të krijojë programe dhe module të reja akademike që reflektojnë nevojat e tregut. Kjo do të thotë që studentët do të kenë mundësi të angazhohen në kërkime që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të rajonit, duke rritur në këtë mënyrë vlerën praktike të studimeve të tyre dhe aftësinë për të gjetur zgjidhje inovative për sfidat reale të tregut.

Gjithashtu, procesi i hartëzimit do të shërbejë si një katalizator për zhvillimin e shkencës ndërdisiplinore brenda universitetit. Duke analizuar të dhënat e mbledhura nga sektorë të ndryshëm të industrisë, universiteti mund të identifikojë fusha të reja për kërkime ndërdisiplinore, ku njohuritë nga disiplina të ndryshme mund të kombinohen për të krijuar zgjidhje të reja dhe inovative. Kjo qasje e re në kërkimet shkencore ndihmon në rritjen e cilësisë dhe ndikimit të kërkimeve, duke sjellë rezultate më të dobishme dhe më të aplikueshme për shoqërinë.

Prandaj mund të konkludojmë se procesi i hartëzimit të bizneseve dhe mbledhja e të dhënave përkatëse janë thelbësore për zhvillimin e shkencës në universitet. Këto aktivitete sigurojnë që kërkimet shkencore të jenë të lidhura ngushtë me nevojat reale të tregut dhe të shoqërisë, duke ndihmuar në rritjen e ndikimit të universitetit në fushën e shkencës dhe inovacionit.

METODOLOGJIA

Krijimi i databazës me informacione për bizneset në Rrafshin e Dukagjinit ka përfshirë mbledhjen dhe organizimin e një gamë të gjerë të detajeve të bizneseve në këtë rajon. Databaza përmban informacione të hollësishme lidhur me llojet e bizneseve, veprimtaritë e tyre specifike, numrin e punëtorëve, kapitalin dhe aspekte të tjera të rëndësishme. Kjo databazë është strukturuar në mënyrë që të lejojë analizën e detajuar të sektorit të biznesit në kontekstin e studimit të Rrafshit të Dukagjinit. Përdorimi i kësaj databaze ka mundësuar një kuptim më të mirë të strukturës së ekonomisë së bizneseve në rajon, duke përfshirë identifikimin e tendencave dhe variablave kryesore që ndikojnë në performancën dhe zhvillimin e tyre. Databaza është krijuar duke shfrytëzuar të dhënat sekondare të shkarkuara nga burimi online Open Data Kosovo (ODK) (2023). Fillimisht janë shkarkuar të dhëna në sasi më të madhe duke përfshirë bizneset aktive, pasive dhe ato të shuara në komunat e Rrafshit të Dukagjinit të përfshira në analizë. Më pas duke e pasur të qartë se mostër e hulumtimit janë bizneset aktive në komunat përkatëse, databaza është sistemuar dhe rregulluar në atë mënyrë që të paraqiten vetëm informacionet dhe të dhënat e nevojshme dhe me interes për hulumtimin.

Këto të dhëna janë organizuar veçmas për çdo komunë për të krijuar databazën dhe për të lejuar qasje dhe analizë të lehtë të informacionit. Të dhënat janë shkarkuar gjatë një periudhe njëjavore, përkatësisht nga data 20 - 26 Maj, ndërsa organizimi dhe sistemimi i tyre ka vazhduar deri në fund të muajit Qershor. Pas krijimit të databazës finale, është realizuar gjithashtu vizualizimi grafik, interpretimi dhe dokumentimi i të dhënave në tërësi. Në databazë përfshihen të dhënat për bizneset që kapin periudhën prej vitin 2000 deri në Qershor të vitit 2023.

Gjatë mbledhjes së të dhënave dhe krijimit të databazës për bizneset në Rrafshin e Dukagjinit janë hasur disa kufizime. Së pari, disponueshmëria dhe aktualizimi i të dhënave kanë qenë të kufizuara në disa burime çka ka ndikuar që të zgjatet koha për sigurimin e informacioneve dhe të dhënave kryesore me interes për hulumtim, duke ndikuar në saktësinë dhe plotësinë e analizës për komunat dhe bizneset. Së dyti, kishte mungesë standardizimi në formatin dhe strukturën e të dhënave të mbledhura, çka ka krijuar sfida në krahasimin dhe analizën e tyre. Së fundmi, kualiteti i të dhënave ka qenë i ulët në disa raste.



FAZAT E HULUMTIMIT


Fazat e përfunduara nga ekipi i hulumtimit për vizualizimin e hulumtimit “Hartëzimi i Bizneseve në Rrafshin e Dukagjinit” përfshijnë:

- Mbledhjen e të dhënave sekondare lidhur me bizneset në Rrafshin e Dukagjinit;
- Organizimin dhe analizën e të dhënave për të identifikuar karakteristikat dhe veprimtaritë e bizneseve në rajon;
- Krijimin e databazës për të lejuar qasje dhe analizë të lehtë të informacionit;
- Vizualizimin grafik të rezultateve dhe trendeve të zbuluara nga analizat për të përcaktuar strukturën dhe zhvillimet në sektorin e bizneseve;

→ Interpretimin dhe dokumentimin e rezultateve të vizualizuara për të paraqitur zbulimet dhe konkluzionet e hulumtimit në mënyrë efektive.

Këto faza kanë siguruar një përqendrim të hollësishëm në të kuptuarit e ekonomisë së bizneseve në Rrafshin e Dukagjinit nëpërmjet një përpjekjeje të koordinuar dhe metodologjike, siç është paraqitur në figurën e mëposhtme (shih Figura 1).

Figura 1. Fazat e hulumtimit



DIZAJNI I DATABAZËS

Dizajni i databazës është konceptuar në mënyrë që të lehtësojë dizajnimin, zhvillimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave të përdorura në këtë hulumtim. Objektivi kryesor i dizajnit të databazës për studimin e bizneseve dhe karakteristikave të tyre në Rrafshin e Dukagjinit është të krijojë modele të dizajnit logjik dhe fizik të sistemit të databazës të propozuar. Modeli logjik fokusohet në kërkesat e të dhënave dhe të dhënat që do të ruhen, pavarësisht nga konsideratat fizike për vendndodhjen dhe strukturën e tyre (Kleynhans, 2020). Kjo kuptohet se nuk ka të bëjë me mënyrën e ruajtjes fizike të të dhënave ose vendndodhjen e tyre në sistemin fizik.

Cikli i dizajnit të databazës përfshin një seri fazash që ndiqen gjatë procesit të zhvillimit të databazave në përgjithësi. Hapat në këtë cikël nuk duhet të ndiqen domosdoshmërisht në një rradhë të drejtë (Alam, 2021).

Në figurën e mëposhtme (shih Figura 2) është listuar çdo hap për një pasqyrë të procesit të dizajnit të databazës së këtij hulumtimi.

- **Planifikimi** - kjo fazë e koncepteve të dizajnit të databazës ka të bëjë me planifikimin e të gjithë ciklit të zhvillimit të databazës.
- **Modeli logjik** - kjo fazë ka të bëjë me zhvillimin e modelit të databazës bazuar në kërkesat specifike. I gjithë dizajni është në letër pa ndonjë zbatim fizik ose konsiderata specifike.
- **Modeli fizik** - kjo fazë zbaton modelin logjik të databazës duke marrë faktorët e zbatimit fizik.
- **Konvertimi dhe ngarkimi i të dhënave** - kjo fazë e dizajnit të databazës ka të bëjë me importimin dhe konvertimin e të dhënave finale.

Ky cikël i zhvillimit siguron një qasje sistematike dhe të strukturuar për projektimin, zhvillimin dhe menaxhimin e databazës.

Figura 2. Dizajni i databazës



Burimi: ISHA (2024)

PËRGATITJA DHE VIZUALIZIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat sekondare janë marrë nga burimi i të dhënave Open Data Kosovo (2023), i cili ofron qasje të lirë dhe të hapur për të gjithë për informacionin dhe databazat publike. Kjo platformë është e disponueshme në tre gjuhë: anglisht, serbisht dhe shqip dhe siguron një gamë të gjerë të të dhënave të strukturuar dhe të organizuara që mund të përdoren për analiza, hulumtime dhe përdorime të ndryshme. Rezultatet nga ky burim paraqiten në një mënyrë të organizuar dhe të përgjithshme, duke dhënë informacion të detajuar për secilin biznes.

Është e rëndësishme të theksohet se platforma Open Data Kosovo, përmes teknikave të skrapimit të faqes zyrtare të internetit të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARKB), ka mbledhur dhe bërë të disponueshëm publikisht informacionin. Për të analizuar tendencat midis të dhënave të ndryshme, si ato demografike, ekonomike dhe gjeografike, platforma përfshin filtra dhe paraqitje vizuale të të dhënave, gjë që ka ndihmuar në mbledhjen e informacioneve për bizneset në Rrafshin e Dukagjinit dhe karakteristikat e tyre. Për sa i përket vizualizimit të të dhënave, ekzistojnë raporte të përgjithshme nga të cilat është marrë informacion bazë, dhe duke përdorur filtra janë procesuar të dhënat që ishin të nevojshme për këtë hulumtim.

Në përgjithësi, është ofruar qasje në një gamë të gjerë të të dhënave për bizneset, duke përzgjedhur vitin dhe llojin e dosjes në interes për hulumtimin. Kjo qasje jo vetëm që rrit përdorshmërinë e platformës, por gjithashtu shërben si një katalizator për vendimmarrje të informuar dhe përpjekje kërkimore në sektorë të ndryshëm (Open Data Kosovo, 2023).

Informacionet e marrë nga Open Data Kosovo (2023) përfshijnë bizneset dhe karakteristikat e tyre në dhjetë komunat vijuese të Rrafshit të Dukagjinit, të cilat janë: Peja, Deçani, Klina, Istogu, Gjakova, Juniku, Prizreni, Rahoveci, Suhareka dhe Malisheva. Informacionet e mbledhura përfshijnë:

- Numrin e bizneseve në secilën komunë,
- Llojin e bizneseve,
- Aktivitetin kryesor të secilit biznes,
- Numrin e punëtorëve të regjistruar,
- Datën e regjistrimit të biznesit, si dhe
- Informacione të tjera demografike dhe ekonomike relevante.

**LLOJET E
BIZNESEVE NË
RRAFSHIN E
DUKAGJINIT**

Komunat e Rrafshit të Dukagjinit përbëjnë një zonë me një gamë të larmishme biznesesh që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të rajonit. Ky diversitet i llojeve të bizneseve kontribuon ndjeshëm në zhvillimin dhe përparimin e ekonomisë lokale, duke krijuar mundësi për punësim dhe rritje ekonomike. Struktura e organizimit të këtyre bizneseve varion nga forma më e thjeshtë deri te ato më komplekse dhe të organizuara, duke reflektuar nevojat dhe specifikat e komunitetit lokal. Në vijim, do të analizohen më në detaje llojet kryesore të bizneseve që operojnë në këtë rajon, duke ofruar një pasqyrë të qartë të kontributit të tyre në ekonominë lokale.

Pra, bizneset e këtij rajoni variojnë nga ato individuale, ku një individ është përgjegjës për të gjitha aspektet e veprimtarisë ekonomike, deri te ndërmarrjet më komplekse si shoqëritë aksionare dhe ndërmarrjet publike. Bizneset individuale dhe ortakëritë e përgjithshme ofrojnë fleksibilitet dhe lehtësi në menaxhim, ndërsa ortakëritë e kufizuara dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar ofrojnë mbrojtje më të madhe të kapitalit të investuar. Ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet shoqërore luajnë një rol kyç në sigurimin e shërbimeve të rëndësishme publike dhe në përfshirjen e komunitetit në aktivitetet ekonomike. Shoqëritë aksionare dhe kooperativat bujqësore përfaqësojnë forma të organizimit të bizneseve që favorizojnë rritjen dhe zhvillimin afatgjatë, duke përfshirë më shumë aktorë dhe burime në tregun lokal. Ky diversitet i llojeve të bizneseve reflekton një ekosistem dinamik dhe të balancuar ekonomik në këtë rajon të rëndësishëm të Kosovës.

Në vazhdim jepen përkufizimet specifike për secilin lloj të bizneseve aktive në komunat e përfshira në analizë, përkatësisht:

Biznes Individual (B.I.) - është personi fizik që është regjistruar në cilësi të biznesit individual dhe i cili, me qëllim të fitimit, në formë të profesionit, kryen veprimtari të ligshme duke përfshirë zejtarinë artistike dhe zejtarinë e vjetër dhe punët artizanale (Krasniqi, 2014, fq. 226).

Ortakëri e Përgjithshme (O.P.) - është forma e organizimit të biznesit ku të gjithë ortakët përgjigjen pa kufizim, e solidarisht për borxhet e shoqërisë (ARBK, n.d.).

Ortakëri e Kufizuar (O.K.) - është forma e organizimit të biznesit në të cilën përveç ortakëve “të pakufizuar” (ortakët që përgjigjen pa kufizim e solidarisht për borxhet e shoqërisë) marrin pjesë edhe ortakët “e kufizuar” ose ata ortakë, që përgjigjen për detyrimet e kompanisë deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre (ARBK, n.d.).

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara (SH.P.K.) - është ajo formë e shoqërisë të cilën e themelojnë një ose më shumë persona juridik dhe/ose fizik në cilësinë e anëtarëve të shoqërisë, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së caktuar nën emrin e përbashkët të biznesit, ndërsa për detyrimet e veta kjo shoqëri përgjigjet me tërë pasurinë e vet. Asnjë anëtar i shoqërisë nuk përgjigjet me pasurinë e vet për detyrimet e shoqërisë (Krasniqi, 2014, fq. 209).

Interes të përgjithshme dhe të cilën e themelon shteti, përkatësisht njësia e vetëqeverisjes lokale. Kjo ndërmarrje themelohet, para së gjithash, për sigurimin e ushtrimit të vazhdueshëm të një veprimtarie me interes ë përgjithshëm dhe për plotësimin e rregullt të nevojave të shfrytëzuesve të prodhimeve dhe shërbimeve, zhvillimin dhe përparimin e ushtrimit të veprimtarisë me interes ë përgjithshëm, si dhe për sigurimin dhe unifikimin e sistemit dhe harmonizimin e zhvillimit të tij (Krasniqi, 2014, fq. 224). Ndërmarrjet publike monitorohen nga Qeveria dhe organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare. Të gjitha interesat pronësore në një ndërmarrje publike përfaqësohen me aksione dhe të gjitha këto aksione duhet të jenë të regjistruara (ARBK, n.d.).

Ndërmarrje Shoqërore (N.SH.) - është ajo ndërmarrje e cila në tërësi punon me kapital shoqëror. Këto ndërmarrje privatizohen në njëfar forme juridike të shoqërisë. Kapitali i ndërmarrje shoqërore është i pjestuar në aksione ose pjesë të caktuara me vlerë nominale dhe regjistrohet në regjistër (Krasniqi, 2014, fq. 223-224).

Shoqëri Aksionare (SH.A.) - është personi juridik të cilën e themelojnë një ose më shumë persona juridik dhe/ose fizik në cilësinë e aksioanarëve me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së caktuar nën emrin e përbashkët, kapitali themelor i së cilës është përcaktuar dhe ndarë në aksione (Krasniqi, 2014, fq. 216). Në shoqërinë aksionare, aksionarët përgjigjen për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me tërë asetet dhe pasurinë e tyre. Shoqëria mund të themelohet dhe të ketë një ose disa aksionar.

Ndërmarrje Publike (N.P.) - është ndërmarrja që ushtron veprimtari me Shuma e kapitalit fillestar të kësaj shoqërie është më së paku 10,000 € (ARBK, n.d.).

Kooperativa Bujqësore (K.B.) - është një shoqëri tregtare e krijuar nga personat fizik apo juridik të cilët duhet të jenë të gjithë bujq që kontribuojnë me pronën e vet private në kapitalin aksionar. Kooperativa e Bujqëve themelohet nga së paku pesë (5) bujq, që janë nënshkruar të detyrimeve. Kooperativa nuk do të themelohet pa kapital e as nuk do të ekzistoj pa kapital. Kapitali ndahet në aksione të vlerës së barabartë me vlerë minimale prej 10 €. Drejtori nuk mund të jetë anëtar i kooperativës (ARBK, n.d.).

Dega e Shoqërisë së Huaj - paraqet një kompani të huaj e cila është shoqëri tregtare dhe pas regjistrimit në Kosovë, ajo konsiderohet si degë, por nuk ka status të veçantë juridik. Pas regjistrimit, kjo degë ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas ligjit në fuqi. Emri zyrtar i kësaj dege duhet të përmbajë emrin e plotë të kompanisë së huaj, të ndjekur nga “Dega në Kosovë” ose shkurt “D.K.” (ARBK, n.d.).

Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM (AKM - Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, paraardhësja e AKP-së - Agjencisë Kosovare të Privatizimit) - ndërmarrje shoqërore dhe publike në Kosovë që i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe administrimit të AKM-së, e cila ka për detyrë të ruajë dhe të rrisë vlerën e tyre, të sigurojë qëndrueshmërinë e tyre afariste dhe të sigurojë një qeverisje të

Në vijim, paraqiten në detaje statistikat e bizneseve sipas llojit në 10 komunat e përfshira në analizë. Tabela 1 ofron një pasqyrë të thelluar dhe të qartë mbi shpërndarjen e bizneseve në këto komuna, duke ndarë ato në kategori të ndryshme si tregtare, prodhuese, shërbimesh dhe të tjera. Analiza e këtyre statistikave ndihmon në kuptimin e strukture së sektorëve të ndryshëm dhe në identifikimin e trendëve të rëndësishëm ekonomikë në nivelin lokal.

Tabela 1. Statistikat e bizneseve sipas llojit në 10 Komuna të përfshira në analizë

Statistikat e bizneseve sipas llojit në 10 Komuna											
	Biznes individual	Ortakëri e përgjithshme	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar	Dega e Shoqërisë së Huaj	Ndërmarrje publike	Ndërmarrje shoqërore	Shoqëri aksionare	Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM	Ortakëri e kufizuar	Kooperativa Bujqësore	Gjithsej
Pejë	3,479	41	1,930	7	1	0	7	0	0	2	5,467
Deçan	701	6	322	1	0	0	2	0	0	1	1,033
Klinë	861	7	534	0	0	1	0	0	0	6	1,409
Istog	1,009	4	510	1	0	0	9	0	0	6	1,539
Junik	34	0	38	0	0	0	0	0	0	0	72
Gjakovë	3,354	21	1,123	3	0	0	10	5	0	1	4,517
Rahovec	1,326	3	507	0	0	0	1	0	0	1	1,838
Suharekë	2,931	16	1,526	11	0	0	5	0	0	6	4,495
Prizren	6,027	57	2,421	27	0	1	6	0	1	6	8,546
Malishevë	1,036	3	506	1	0	0	3	0	0	1	1,550
Gjithsej	20,758	158	9,417	51	1	2	43	5	1	30	30,466

Burimi: Open Data Kosovo (2023), përshtatur dhe modifikuar nga ISHA


Sipas rezultateve të paraqitura në Tabelën 1, mund të vërehet se

- Në Komunën e Pejës janë gjithsej 5,467 biznese aktive. Nga këto, 3,479 biznese janë të regjistruara si “Biznes individual”, 41 biznese si “Ortakëri e përgjithshme”, 1,930 biznese si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, 7 biznese si “Dega e Shoqërisë së Huaj”, 1 biznes si “Ndërmarrje publike”, 7 biznese si “Shoqëri aksionare” dhe 2 biznese si “Kooperativa Bujqësore”.
- Në Komunën e Deçanit janë gjithsej 1,033 biznese aktive. Nga këto, 701 biznese janë të regjistruara si “Biznes individual”, 6 biznese si “Ortakëri e përgjithshme”, 322 biznese si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, 1 biznes si “Dega e Shoqërisë së Huaj”, 2 biznese si “Shoqëri aksionare” dhe 1 biznes si “Kooperativë Bujqësore”.
- Në Komunën e Klinës janë gjithsej 1,409 biznese aktive. Nga këto, 861 biznese janë të regjistruara si “Biznes individual”, 7 biznese si “Ortakëri e përgjithshme”, 534 biznese si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, 1 biznes si “Ndërmarrje shoqërore” dhe 6 biznese si “Kooperativa Bujqësore”.

- Në Komunën e Istogut janë gjithsej 1,539 biznese aktive. Nga këto, 1,009 biznese janë të regjistruara si “Biznes individual”, 4 biznese si “Ortakëri e përgjithshme”, 510 biznese si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara”, 1 biznes si “Dega e Shoqërisë së Huaj”, 9 biznese si “Shoqëri aksionare” dhe 6 biznese si “Kooperativa Bujqësore”.
- Në Komunën e Junikut janë gjithsej 72 biznese aktive. Nga këto, 34 biznese janë të regjistruara si “Biznes individual” dhe 38 biznese si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara”.
- Në Komunën e Gjakovës janë gjithsej 4,517 biznese aktive. Nga këto, 3,354 biznese janë të regjistruara si “Biznes individual”, 21 biznese si “Ortakëri e përgjithshme”, 1,123 biznese si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara”, 3 biznese si “Dega e Shoqërisë së Huaj”, 10 biznese si “Shoqëri aksionare” 5 biznese si “Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM” dhe 1 biznes si “Kooperativë Bujqësore”.
- Në Komunën e Rahovecit janë gjithsej 1,838 biznese aktive. Nga këto, 1,326 biznese janë të regjistruara si “Biznes individual”, 3 biznese si “Ortakëri e përgjithshme”, 507 biznese si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara”, 1 biznes si “Shoqëri aksionare” dhe 1 biznes si “Kooperativë Bujqësore”.
- Në Komunën e Suharekës janë gjithsej 4,495 biznese aktive. Nga këto, 2,931 biznese janë të regjistruara si “Biznes individual”, 16 biznese si “Ortakëri e përgjithshme”, 1,526 biznese si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara”, 11 biznese si “Dega e Shoqërisë së Huaj”, 5 biznese si “Shoqëri aksionare” dhe 6 biznese si “Kooperativa Bujqësore”.
- Në Komunën e Prizrenit janë gjithsej 8,546 biznese aktive. Nga këto, 6,027 biznese janë të regjistruara si “Biznes individual”, 57 biznese si “Ortakëri e përgjithshme”, 2,421 biznese si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara”, 27 biznese si “Dega e Shoqërisë së Huaj” 1 biznes si “Ndërmarrje shoqërore”, 6 biznese si “Shoqëri aksionare”, 1 biznes si “Ortakëri e kufizuar” dhe 6 biznese si “Kooperativa Bujqësore”.
- Në Komunën e Malishevës janë gjithsej 1,550 biznese aktive. Nga këto, 1,036 biznese janë të regjistruara si “Biznes individual”, 3 biznese si “Ortakëri e përgjithshme”, 506 biznese si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara”, 1 biznes si “Dega e Shoqërisë së Huaj”, 3 biznese si “Shoqëri aksionare” dhe 1 biznes si “Kooperativë Bujqësore”.

Në vijim, do të shqyrtojmë në detaje statistikat e bizneseve sipas llojit në 10 komunat e përfshira në analizë përmes grafikëve vizualë. Këto grafikë ofrojnë një përmbledhje të qartë dhe të strukturuar të të dhënave, duke ilustruar shpërndarjen dhe ndarjen e bizneseve në kategori të ndryshme në nivel lokal. Grafikët do të ndihmojnë në analizimin e tendencave dhe në theksimin e diferencave midis komunave, duke ofruar një pasqyrë të hollësishme mbi strukturën dhe aktivitetin ekonomik në këto zona.

Grafiku 1. Statistikat e bizneseve sipas llojit në 10 Komunat e përfshira në analizë




Burimi: ISHA (2024)

Duke ju referuar Tabelës 1 dhe Grafikut 1 shihet se, totali i bizneseve të regjistruara në 10 Komunat e Rrafshit të Dukagjinit të përfshira në analizë është 30,466. Nga këto, 20,758 biznese janë të regjistruara si “Biznes Individual”, 158 biznese janë të regjistruara si “Ortakëri e përgjithshme”, 9,418 biznese janë të regjistruara si “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara”, 51 biznese janë të regjistruara si “Dega e Shoqërisë së Huaj”, 1 biznes është i regjistruar si “Ndërmarrje publike”, 2 biznese janë të regjistruara si “Ndërmarrje shoqërore”, 43 biznese janë të regjistruara si “Shoqëri aksionare”, 5 biznese janë të regjistruara si “Ndërmarrje tjera nën juridiksion të AKM”, 1 biznes është i regjistruar si “Ortakëri e kufizuar” dhe 30 biznese janë të regjistruara si “Kooperativa Bujqësore”.

Shënim: Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi strukturën e bizneseve dhe ndihmojnë në identifikimin e tipareve kryesore të aktivitetit ekonomik në këto komuna. Analiza e këtyre statistikave është e rëndësishme për të kuptuar shpërndarjen dhe diversitetin e sektorëve të biznesit në rajonin e Rrafshit të Dukagjinit.

Në vijim do të prezantohen statistikat e bizneseve sipas llojit për të gjitha komunat bashkërisht, me qëllim që të ofrohet një pasqyrë e plotë dhe e krahasueshme e përhapjes dhe diversifikimit të bizneseve në nivel rajonal, duke ndihmuar në identifikimin e tendencave dhe mundësive të zhvillimit ekonomik në këtë zonë.

Grafiku 2. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Biznes Individual” në 10 Komunat e përfshira në analizë




Burimi: ISHA (2024)

Në përputhje me Grafikon 2, vërehet se numri i bizneseve individuale ndryshon nga një komunë në tjetër. Në komunën e Pejës janë regjistruar 3,479 biznese individuale, që përbëjnë 17% të totalit. Në komunën e Deçanit, numri i bizneseve individuale është 701, ose 3% e totalit. Komuna e Klinës ka të regjistruar 861 biznese të tipit "Individual", që përfaqësojnë 4% të totalit. Në Istog janë regjistruar 1,009 biznese individuale, që përbëjnë 5% të totalit. Komuna e Junikut ka vetëm 34 biznese të këtij lloji, duke përbërë 0% të totalit. Në Gjakovë, numri i bizneseve individuale është 3,354, ose 16% e totalit. Rahoveci ka të regjistruar 1,326 biznese individuale, që përbëjnë 6% të totalit. Suhareka ka 2,931 biznese të këtij tipi, përfaqësues të 14% të totalit. Në Prizren, janë të regjistruara 6,027 biznese individuale, që përbëjnë 29% të totalit. Së fundmi, në Malishevë janë të regjistruara 1,036 biznese individuale, që përfaqësojnë vetëm 5% të totalit.

Siç mund të vërehet, komuna e Prizrenit ka numrin më të lartë të bizneseve të tipit “Biznes Individual”, e ndjekur nga komunat e Pejës, Gjakovës dhe Suharekës. Në këto komuna, numri i bizneseve individuale është gjithashtu relativisht i lartë, duke treguar një prirje të fortë për këtë lloj aktiviteti ekonomik në rajon.

Shënim: Kjo ndarje e ndryshme e sugjeron një shpërndarje të pabarabartë të bizneseve individuale në nivel lokal dhe mund të reflektojë mbi faktorë të tillë si mundësitë ekonomike, politikat lokale dhe kapacitetet infrastrukturore në këto zona.

Grafiku 3. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Ortakëri e Përgjithshme” në 10 Komunat e përfshira në analizë




Burimi: ISHA (2024)

Në përputhje me Grafikon 3, vërehet se distribucioni i bizneseve të tipit “Ortakëri e përgjithshme” ndryshon ndërmjet komunave. Në komunën e Pejës janë regjistruar 41 biznese të këtij lloji, që përbëjnë 26% të totalit. Në komunën e Deçanit, janë 6 biznese, që përfaqësojnë 4% të totalit. Në Klinë janë regjistruar 7 biznese të tipit “Ortakëri e përgjithshme,” ose 4% e totalit. Komuna e Istogut ka 4 biznese të këtij tipi, që përbëjnë 3% të totalit. Në Junik, nuk ka asnjë biznes të regjistruar si “Ortakëri e përgjithshme,” që reflekton 0% të totalit. Në Gjakovë janë regjistruar 21 biznese të këtij lloji, që përfaqësojnë 13% të totalit. Rahoveci ka 3 biznese të tipit “Ortakëri e përgjithshme,” përbërë 2% të totalit. Në Suharekë janë 16 biznese të këtij lloji, ose 10% e totalit. Prizreni ka regjistruar 57 biznese të tipit “Ortakëri e përgjithshme,” që përbëjnë 36% të totalit. Së fundmi, në Malishevë janë regjistruar 3 biznese të këtij tipi, që përfaqësojnë gjithashtu 2% të totalit.

Në kategorinë e bizneseve të tipit “Ortakëri e Përgjithshme,” komuna e Prizrenit ka numrin më të lartë të bizneseve të regjistruara, e ndjekur nga komuna e Pejës. Në këto komuna, numri i bizneseve të këtij lloji është gjithashtu relativisht i lartë, duke treguar një prirje të fortë për këtë lloj aktiviteti ekonomik në rajon.

Shënim: Në përgjithësi, prirjet tregojnë se disa komuna kanë një aktivitet të lartë në formën e “Ortakëri e përgjithshme.” Kjo sugjeron se në këto zona ka një mbështetje më të madhe për këtë lloj biznesi, ndoshta për shkak të një klime më të favorshme për investime, mbështetjes nga institucionet lokale, ose një ndërgjegjësimi të lartë mbi përfitimet e këtij modeli.

Grafiku 4. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” në 10 Komunat e përfshira në analizë




Burimi: ISHA (2024)

Në përputhje me Grafikon 4, rezulton se numri i bizneseve të tipit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ndryshon ndërmjet komunave. Në komunën e Pejës janë regjistruar 1,930 biznese të këtij lloji, që përbëjnë 20% të totalit. Në Deçan, janë 322 biznese të tipit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar,” përfaqësuese të 3% të totalit. Klina ka të regjistruar 534 biznese të këtij tipi, që përbëjnë 6% të totalit. Komuna e Istogut ka 510 biznese të tipit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar,” që përfaqësojnë 5% të totalit. Në Junik, numri i bizneseve të këtij lloji është 38, që përfaqësojnë 0% të totalit. Në Gjakovë janë të regjistruara 1,123 biznese të këtij tipi, që përbëjnë 12% të totalit. Rahoveci ka 507 biznese të tipit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar,” duke përbërë 5% të totalit. Në Suharekë janë të regjistruara 1,526 biznese të këtij lloji, që përfaqësojnë 15% të totalit. Prizreni ka të regjistruara 2,421 biznese të tipit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar,” që përbëjnë 26% të totalit. Së fundmi, në Malishevë janë 506 biznese të këtij tipi, që përfaqësojnë 5% të totalit.

Në kategorinë e bizneseve të tipit “Ortakëri e Përgjithshme,” komuna e Prizrenit ka numrin më të lartë të bizneseve të regjistruara, e ndjekur nga komunat e Pejës dhe Suharekës. Në këto komuna, numri i bizneseve të këtij lloji është gjithashtu relativisht i lartë, duke treguar një prirje të fortë për këtë aktivitet ekonomik në rajon.

Shënim: Përfundimisht, vërehet se shpërndarja e bizneseve “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ndryshon ndjeshëm mes komunave. Disa komuna kanë numra të lartë të këtyre bizneseve, duke reflektuar mbështetje të fortë dhe mundësi për zhvillim ekonomik. Ndërsa, në komuna me numër më të ulët, është e nevojshme mbështetje shtesë dhe zhvillim politikash për të inkurajuar këtë lloj biznesi.

Grafiku 5. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Dega e Shoqërisë së Huaj” në 10 Komunat e përfshira në analizë




Burimi: ISHA (2024)

Duke iu referuar Grafikut 5, vërehet se në komunën e Pejës janë regjistruar gjithsej 7 biznese të tipit “Dega e Shoqërisë së Huaj,” që përfaqësojnë 14% të totalit. Në komunën e Deçanit është regjistruar gjithsej 1 biznes i këtij tipi, që përfaqëson 2% të totalit. Në komunën e Klinës dhe atë të Junikut nuk janë regjistruar biznese të këtij tipi. Në komunën e Istogut është regjistruar gjithsej 1 biznes, që përfaqëson 2% të totalit. Në komunën e Gjakovës janë regjistruar gjithsej 3 biznese të tipit “Dega e Shoqërisë së Huaj,” që përfaqësojnë 6% të totalit. Në komunën e Rahovecit nuk janë regjistruar biznese të këtij tipi. Në komunën e Suharekës janë regjistruar 11 biznese, që përfaqësojnë 22% të totalit. Në komunën e Prizrenit janë regjistruar gjithsej 27 biznese të tipit “Dega e Shoqërisë së Huaj,” që përfaqësojnë 53% të totalit. Ndërsa në komunën e Malishevës është regjistruar 1 biznes i këtij tipi, që përfaqëson 2% të totalit.

Në kategorinë e bizneseve të tipit “Dega e Shoqërisë së Huaj,” komuna e Prizrenit ka numrin më të lartë të bizneseve të regjistruara, e ndjekur nga komuna e Suharekës. Në këto komuna, numri i bizneseve të këtij lloji është gjithashtu relativisht i lartë, duke reflektuar një prirje të fortë për këtë lloj aktiviteti ekonomik në rajon.

Shënim: Mund të konkludohet se shpërndarja e bizneseve të tipit “Dega e Shoqërisë së Huaj” ndryshon ndjeshëm mes komunave. Ndërsa disa komuna tregojnë një prirje të fortë për investime të huaja, në të tjera numri i bizneseve të këtij tipi është shumë i ulët ose i papërfillshëm. Kjo sugjeron nevojën për strategji më të fuqishme për të inkurajuar këtë aktivitet ekonomik.

Grafiku 6. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Ndërmarrje Publike” në 10 Komunitat e përfshira në analizë




Burimi: ISHA (2024)

Duke iu referuar Grafikut 6, vërehet se në komunën e Pejës është regjistruar gjithsej 1 biznes i tipit “Ndërmarrje Publike,” që përfaqëson 100% të totalit. Ndërsa në komunat e Deçanit, Klinës, Istogut, Junikut, Gjakovës, Rahovecit, Suharekës, Prizrenit dhe Malishevës nuk janë regjistruar biznese të këtij lloji, duke përfaqësuar 0% të totalit.

Në kategorinë e bizneseve të tipit “Ndërmarrje Publike,” Peja është e vetmja komunë që ka një prezencë të tillë, duke reflektuar një fokus të veçantë në këtë sektor në krahasim me pjesën tjetër të rajonit.

Shënim: *Si përfundim, është e qartë se komuna e Pejës është e vetmja në rajon që ka të regjistruar biznese të tipit “Ndërmarrje Publike,” duke pasur kështu një dominim të plotë në këtë kategori. Ky singularitet sugjeron një fokus të veçantë dhe ndoshta një strategji të ndryshme në zhvillimin e sektorit publik në Pejë në krahasim me komunat e tjera. Kjo situatë mund të ofrojë mundësi për analiza të mëtejshme mbi faktorët që kontribuojnë në këtë diferencë dhe mund të ndihmojë në zhvillimin e politikave për të përmirësuar diversifikimin e sektorit të ndërmarrjeve publike në rajon.*

Grafiku 7. Statistikat e bizneseve sipas llojit “Ndërmarrje Shoqërore” në 10 Komunat e përfshira në analizë




Burimi: ISHA (2024)

Duke iu referuar Grafikut 7, vërehet se në komunën e Klinës është regjistruar gjithsej 1 biznes i tipit “Ndërmarrje Shoqërore,” që përfaqëson 50% të totalit. Po ashtu, në komunën e Prizrenit është regjistruar gjithsej 1 biznes i tipit “Ndërmarrje Shoqërore,” që përfaqëson gjithashtu 50% të totalit. Ndërsa në komunat e Pejës, Deçanit, Istogut, Junikut, Gjakovës, Rahovecit, Suharekës dhe Malishevës nuk janë regjistruar biznese të këtij lloji, duke përfaqësuar 0% të totalit.

Në kategorinë e bizneseve të tipit “Ndërmarrje Shoqërore,” Klina dhe Prizreni janë të vetmet komuna që kanë një prezencë të tillë, duke reflektuar një fokus të veçantë në këtë sektor në krahasim me pjesën tjetër të rajonit.

